



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

KONTRAKTORI "ARBENS GARTEN PARADISE" NNT Komuna e Istogut, të cilën e përfaqëson z. Berat Imeraj, me Nr. Rexh. Biznesi, 70913607 (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

NDËRTIMI I KANALIZIMIT LUBOZHDE-Laxha "JANUZAJ"

Nr. I prokurimit	633-18-7668-2-1/C 161
Nr. I brendshëm	633 / 018 / 075 / 521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

NDËRTIMI I KANALIZIMIT LUBOZHDE-Laxha "JANUZAJ"

Neni 2 Çmimi 2.1 Çmimi total i punëve për aktivitetin e prokurimit:
NDËRTIMI I KANALIZIMIT LUBOZHDE-Laxha "JANUZAJ" është:
18.900,00 € dhe me fjalë: /Tetëmbdhjetë mijë nëntë çindeuro €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në rast të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për: Autoritetin Kontraktues:
KOMUNA E ISTOGUT

Për: Kontraktuesin:
"ARBENS GARTEN PARADISE"

Emri:	<i>Zizë Bujupaj</i>	Emri:	<i>Berat Imeraj</i>
Pozita:	<i>Zyrtar Përgjrgjës i Prokurimit</i>	Pozita:	<i>D r e j t o r</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<i>23.11.2018</i>	Data:	<i>23.11.2018</i>
Vu la		Vu la	

Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë llogaritura për ditë dhe atë 0.25 % për ç'do ditë vonese te paarsyeshme. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e çmimit final të Kontratës.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Kompanija mbikqyrëse "SIB BKA" & "LIRIU", nga Gjakova e kontraktuar nga Autoriteti Kontraktues, është mbikqyrëse e kontratës, e cila ka për obligim ta përcjellë rrjedhën e punimeve dhe të raportojë AK-në për rrjedhat dhe permbushjen me sukses të kontratës. Ose Drejtatori perkates i inicimit të kërkeses dote caktojë një zyrtar për implementim të kësaj kontrate.
Pagesat	24.1	Pagesat do të bëhen në euro ashtu si raporton Organi Mbikqyrës, bazuar në raportin e mbikqyrësit, pas kryerjes së punimeve për situacionet përkatëse.
Përmlirësimi i defekteve	31.1	Periudha garantuere e defekteve është 365 ditë, pas përfundimit të instalimit, bazuar në deklaratën e kontraktorit.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.1	KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore - Departamenti për çështje Ekonomike - Prishtinë. Palet duhet të deklarohen para nënshkrimit të kontratës – për KOMPETENCËN, për kontestet eventuale Gjykata apo Arbitrazhi.